



Prishtinë: 10.08.2016
Kodi i ZRRE-së: V_837_2016

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 8, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.6, neni 14, paragrafi 2, nën-paragrafi 2.14 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr.03/L—185);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_V_1504_06_16**;
- Ankesa e KESCO-së e datës **25.07.2016**

në seancën e mbajtur më datë 10 gusht 2016, nxori këtë:

V E N D I M

- I **REFUZOHET** ankesa e konsumatorit I. M., me shifër DFE - 3148 ndaj vendimit të DMK-së, si në arsyet e paraqitura në arsyetimin e këtij vendimi.
- II **Mbetet në fuqi** vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve nr. **ZRRE/DMK_V_1504_06_16** i datës 29.06.2016.

A r s y e t i m

Zyra e Rregullatorit për Energji me datë 25.07.2016 ka pranuar ankesën e parashtruar nga konsumatori I. M. i cili ka kundërshtuar vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE për këto shkaqe: interpretimin e gabuar të shkresës së Bordit të KEK-ut nr.870 të datës 17.04.2014 drejtuar Qeverisë me qëllim të përkrahjes së kategorive sociale të cilët kanë borxhe të pashlyera ndaj KEK-ut deri më 1 shkurt 2013; interpretimin e gabuar të vendimit të Qeverisë nr.02/183 të datës 8.04.2014 nga pika 1.2 dhe 1.3 si dhe mosinterpretimin e Ligjit për Marrëdhëniet Detyrimore, neni 378 paragrafi 1 dhe nr.04/L-077, neni 360 paragrafi 1.1 dhe 1.2 për afatin njëvjeçar. Konsumatori në ankesë ka kërkuar nga Bordi i ZRRE-së që të merr për bazë kërkesën për parashkrim borxhi i cili borxh është vjetërsuar

Me datë 08.01.2016 konsumatori ka parashtruar ankesë në Departamentin për Konsumator në KESCO, duke theksuar se kundërshton borxhin e energjisë elektrike

Me datë 13.01.2016 Departamenti për Konsumator në KESCO i ka kthyer përgjigje konsumatorit duke e refuzuar ankesën e tij në arsyetimin se kërkesa e konsumatorit për shlyerjen e borxhit është në kompetencën e KEK-ut dhe jo të KESCO-s.

I pakënaqur me përgjigjen e lëshuar Departamenti për konsumator në KESCO, konsumatori ka parashtruar ankesë në DMK të ZRRE-së, me të cilën ka kundërshtuar përgjigjen e KESCO, për refuzim të ankesës së tij. Konsumatori në ankesë ka theksuar se kërkon shlyerjen e borxhit (dënimeve) në bazë të Ligjit nr. 05/L-043 për Faljen e Borxheve Publike. Konsumatori në ankesën e tij ka theksuar se sipas Listës së përfituesve për faljen e borxheve borxhi për shlyerje është 4,106.29€, ndërsa për



pagesë është 770.67€. Konsumatori ka theksuar se borxhin për pagesë prej 770.67€ e kundërshton pasi ai borxh duhet të shlyhet në bazë të Ligjit nr. 05/L-043, neni 3, paragrafi 1.2, neni 4, paragrafi 1.1 dhe neni 6, paragrafi 1. Konsumatori në vazhdim të ankesës ka theksuar se në shumën e borxhit prej 770.67€ janë të përfshirë edhe njoftimet për shkycje dhe shkycjet e të cilat kanë ndodhur prej 19.08.2005 deri më datën 04.07.2008 dhe atë deri më 701.50€. Gjithatsh sipas ligjit 03/L-185 për ZRRE-në, neni 2, paragrafi 1.10 konsumatorët në nevojë dhe neni 45 subvencionimi i konsumatorëve në nevojë, e klasifikuar nga MPMS. Si përfitues i skemës për ndihme sociale nga MPMS nuk është marrë për bazë fare vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës nr.02/183 i datës 18.04.2014 për faljen e borxheve të KEK-ut

Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE, si organ i shkallës së parë duke u bazuar në analizat e bëra dhe argumentet e paraqitura ka shqyrtuar ankesën e konsumatorit dhe pas shqyrtimit të ankesës ka **refuzuar** ankesën e konsumatorit si të pabazuar.

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji në mbledhjen e mbajtur me datë 10.08.2016 ka analizuar të gjitha shkresat e lëndës të prezantuar nga ana e konsumatorit I. M., si dhe vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe pas kësaj ka vërtetuar se vendimi i DMK-së është vendim i drejtë dhe i bazuar në prova konkrete.

Bordi i ZRRE-së pas analizimit të shkresave të lëndës dhe vendimit të DMK-së ka vërejtur se organi i shkallës së parë DMK me të drejtë ka vërtetuar gjithë gjendjen faktike të konsumatorit dhe ka evidentuar të gjitha veprimet e ndërmarra në këtë pikë matëse

Bordi i ZRRE-së ka analizuar edhe pikën kundërshtuese të konsumatorit me të cilën është theksuar se organi i shkallës së parë ka bërë interpretim të gabuar shkresës së Bordit të KEK-ut nr.870 të datës 17.04.2014 dhe Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës nr.02/183 të datës 18.04.2014. Lidhur me këtë pikë Bordi i ZRRE-së ka analizuar dy shkresat e theksuar më lartë dhe konstaton se organi i shkallës së parë me të drejtë ka konstatuar se Vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës nr.02/183 të datës 18.04.2014 është një vendim i cili ka rekomanduar Bordin e KEK-ut që të analizojë mundësinë që familjet në asistencë sociale dhe atë që kanë qenë në asistencë sociale deri më 1 shkurt 2013 (gjegjësisht deri në momentin kur distribucioni është privatizuar) të shlyhen borxhet ndaj KEK. Po ashtu Bordi i ZRRE-së ju informon se organi i shkallës së parë me të drejtë ka dërguar një shkresë zyrtare duke kërkuar informata se ka bërë KEK-u ndonjë veprim për shlyerje të borxhit të kategorisë së konsumatorëve të rasteve sociale, dhe se në përgjigjen e KEK-ut drejtuar ZRRE-së është theksuar se KEK-u kishte filluar analizimin e situatës për të filluar procedurat për të përgatitur listat, meqenëse bazën e shënimeve nuk e posedon KEK dhe është dashtë të bashkëpunohet me furnizuesin Publik (KEDS/KESCO) për këtë çështje, mirëpo në ndërkohë Parlamenti i Republikës së Kosovës ka aprovuar Ligjin për faljen e borxheve publike Nr. 05/L-43, i cili ligje e obligon KEK-un të merret me faljen e borxheve të konsumatorëve.

Bordi i ZRRE-së ka analizuar me kujdes ka analizuar edhe pjesën e ankesës suaj me të cilin keni evidentuar edhe Ligjin për Faljen e Borxhit dhe konstaton se organi i shkallës së parë me të drejtë ka shtjelluar edhe këtë pikë. Bordi i ZRRE-së konstaton se konsumatorëve të cilëve i është krijuar borxhi i energjisë elektrike, për t'iu nënshtruar përfitimit të Ligjit për falje të borxhit, duhet që për t'iu falur borxhi i energjisë elektrike deri me datën 31.12.2008 duhet të plotësojnë kriteret e nenit 4, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1 ose 1.2 të këtij ligji, pra të bëjnë pagesën e plotë të borxhit të energjisë elektrike nga data 01 janar 2009 deri me 31 dhjetor 2014, ose të nënshkruajnë marrëveshje për pagesë. Gjithastu vlen të theksohet se te rasti i konsumatorit sipas transaksioneve të konsumatorit vërehet se në pjesën e shlyerjes së borxhit deri më datën 31.12.2008 sipas Ligjit nr. 05/L-043 për Faljen e Borxheve Publike, janë përfshirë edhe të gjitha ngarkesat për njoftime dhe shkycje të realizuara nga KEK-u ndaj konsumatorit.



Bordi i ZRRE-së ka analizuar kërkesën e konsumatorit që ka të bëjë me parashkrim të borxhit të energjisë elektrike dhe për këtë ka vendosur se ZRRE nuk ka vërtetuar ndonjë element të parashkrimit të borxhit të energjisë elektrike, ne kemi analizuar gjithë lëndën lidhur me grumbullimin e borxhit të energjisë elektrike. Andaj lidhur me çështjen e parashkrimit të borxhit Bordi ka konstatuar se për raste të tilla konsumatori mund t'i drejtohet gjykatave kompetente.

Bordi ka konstatuar se organi i shkallës së parë ka vërtetuar gjendjen faktike në mënyrë të drejtë dhe të plotë pasi që janë analizuar në detaje të gjitha shkresat dhe ligjet në fuqi dhe mbi këtë bazë ka konstatuar se konsumatori në ankesën e saj nuk ka ofruar asnjë provë bindëse për të vërtetuar faktin se vendimi i DMK-së si organ i shkallës së parë nuk është vendim i drejtë dhe i bazuar në rregulla dhe ligje.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 10.08.2016 pas analizimit të krejt asaj që u theksua më lartë, ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

- III. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versionin në gjuhën shqipe.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Bordi i ZRRE-së:

Enver Halimi, kryesues

Krenar Bujupi, anëtar

Arsim Janova, anëtar

Qemajl Mustafa, anëtar

Besim Sejfiqaj, anëtar

Vendimi iu dërgohet:

- Konsumatorit I. M.,
- KESCO-së, Divizioni i Furnizimit; dhe
- Arkivit të ZRRE-së.